


## Observeri i Kosovës:

Lufta Diplomatike Ruse  
dhe Dezinformimi Medial

1 qershor – 15 gusht, 2021



---

#### INFORMATA BAZIKE:

Observeri i Kosovës: Lufta Diplomatike Ruse dhe Dezinformimi Medial – është një raport tremujor që synon t’i analizojë deklaratat publike dhe publikimet të establishmentit të politikës së jashtme të Rusisë, dhe veçoritë e lajmeve që përmbajnë dezinformata dhe keqinformim që kanë për shënjestër Kosovën, të publikuara nga mediat ruse në gjuhën angleze dhe serbe.

---

#### PËRKRAHUR NGA::



Londër, Mbretëria e Bashkuar

---

#### VËREJTJE:

Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim janë vetëm të Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED).

---

#### KONTAKTI:

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

Rr. Major Mehmet Bushi, H.III/1, 10 000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0)38 542 778

Web-site: [www.kipred.org](http://www.kipred.org)

Email: [info@kipred.org](mailto:info@kipred.org)

## Përmbledhje Ekzekutive

**Observeri i Kosovës: Lufta Diplomatike Ruse dhe Dezinformimi Medial** është një raport tremujor që synon t'i analizojë deklaratat publike, konferencat për shtyp, artikujt dhe dokumentet e tjera të botuara në ueb-faqet e Kremlinit, të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Federatës Ruse, të Misionit të Përhershëm Rus në Kombet e Bashkuara, të Misionit të Përhershëm të Rusisë në OSBE, të Përfaqësimit të Përhershëm Rus në Këshillin e Europës, dhe të Ambasadës Ruse në Serbi, e që janë zëdhënësit kyç në luftën diplomatike ruse kundër Kosovës. Pos kësaj, ky Observer analizon veçoritë e lajmeve që përmbajnë dezinformata për Kosovën që janë botuar nga mediat e përzgjedhura, dhe atë nga Russia Today, Sputnik International, Sputnik Serbia, Meduza, Russia Insider, TASS, The Moscow Times, Newsfront, Unz, The Duran dhe Pravda Report, e që janë dorë e zgjatur e establishmentit të Politikës së Jashtme Ruse në luftën e saj diplomatike kundër Kosovës.

Nga ky këndvështrim, analizat e deklaratave, të konferencave për shtyp, të artikujve dhe dokumenteve të tjerë të establishmentit rus të politikës së jashtme, nga 1 qershori deri më 15 gusht, 2021, e tregojnë qartë vazhdimësinë e synimit të narrativave për t'i gërryer themelet e shtetësisë së Kosovës dhe të angazhimit të Perëndimit në Kosovë dhe në rajon, pastaj, për t'i ndryshuar narrativat për krimet e luftës në ish-Jugosllavi, duke ia gërryer, në këtë mënyrë, themet drejtësisë ndërkombëtare, për ta akuzuar Kosovën për shtypjen e serbëve lokalë dhe të Kishës Ortodokse Serbe, si dhe për mosrespektimin e marrëveshjes për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, si dhe për ta krahasuar rastin e Kosovës me atë të Krimesë. Këta narrativa që e strukturojnë luftën diplomatike të Rusisë kundër Kosovës, përgjithësisht janë të shoqëruara me dezinformime të botuara nga mediat e përzgjedhura të përmendura më sipër.

Në këtë kuadër, një moment tejet i rëndësishëm i luftës diplomatike ruse kundër Kosovës do të krijohet pas përfundimit të marrëveshjes për moratoriumin e Kosovës për të kërkuar anëtarësimë në organizatat ndërkombëtare, si dhe për fushatën e Serbisë për mosnjohjen e Kosovës, e që do të pushojnë më 3 shtator, 2021, e që do të përputhet me hapjen e Sesionit të 76 të Asamblesë së Përgjithshme të KB. Ky moment mund të shfrytëzohet nga Rusia për të punuar bashkarisht me Serbinë për ta bërë një fushatë agresive për çnjohjen e Kosovës gjatë veprimit të këtij Sesionit dhe menjëherë pas tij.

## Lufta Diplomatike Ruse kundër Kosovës

Gjatë kësaj periudhe, Kremli, Ministria e Jashtme Ruse dhe Misioni i Përhershëm Rus në Kombet e Bashkuara, e kanë shënjestruar Kosovën në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo në një kontekst më të gjerë, në një numër deklaratash, konferencash për shtyp, raportesh dhe artikujsh, ndërkohë që Misioni i Përhershëm i Ruisë në OSBE, Përfaqësimi i Përhershëm Rus në Këshillin e Evropës, dhe Ambasada Ruse në Serbi nuk kanë postuar në ueb-sajtet e tyre kurrfarë publikimesh të ndërlidhura me Kosovën. Në kuadër të krejt kësaj, teksti në vijim do t'i paraqesë analizat kronologjike të këtyre aktiviteteve të shënjestruara të luftës diplomatike ruse kundër Kosovës.

Lidhur me këtë, në deklaratën e 8 qershorit, 2021, të dhënë në takimet e Këshillit të Sigurisë të KB për marrjen parasysh të raportit të Mekanizmit Ndërkombëtar Rezidual për Tribunalet Kriminale,<sup>1</sup> Zëvendës-Përfaqësuesi i Përhershëm i Ruisë, G.V. Kuzmin, e akuzoi Tribunalin Ndërkombëtar Kriminal për ish-Jugosllavinë (ICTY) që ky “u bë i verbër dhe i shurdhër ndaj disa krimeve të caktuara, duke u bërë kinse nuk po shihte krime evidente të shqiptarëve kosovarë,” raste këto që tash janë duke u trajtuar nga Dhomat Speciale të Kosovës, të vendosura në Hagë. Përfaqësuesi rus Kuzmin, të gjitha këto i tha në të njëjtën kohë kur, për ironi, ishte duke e arsyetuar dhe e mbrojtur mos-bashkëpunimin e Serbisë me Mekanizmin Ndërkombëtar Rezidual. Mirëpo, duhet vërejtur që, në një mënyrë paradoksale, ishte pikërisht Rusia ajo që ishte duke e ushtruar një trysni shumë të madhe për akuza të shpejta për krimet e pretenduara nga Dhomat Speciale të Kosovës,<sup>2</sup> në të njëjtën kohë kur është duke bërë përpjekje për ta diskredituar kredibilitetin e ICTY, i cila ishte krijuar me përkrahjen e Moskës të Rezolutës 827 të Këshillit të Sigurisë të KB të 25 majit, 1993.<sup>3</sup>

Nga ana tjetër, në një deklaratë të 10 qershorit, 2021,<sup>4</sup> në informimin e Këshillit të Sigurisë së KB për bashkëpunimin midis KB dhe organizatave rajonale, Zëvendës-Përfaqësuesi i Parë i Përhershëm rus, Dmitry Polyanskiy, pos dënimit të politikës së Bashkimit Evropian ndaj Ruisë për konfliktin në Ukrainë, e kritikoi Brukselin edhe për atë që në Kosovë është “duke e luajtur lojën ashtu siç i konvenon

---

<sup>1</sup> [Permanent Mission of the Russian Federation to the United Nations \[Misioni i Përhershëm i Federatës Ruse në KB\] \(russiaun.ru\)](https://www.mfa.gov.ru/en/foreign_relations/missions/mission_to_un/)

<sup>2</sup> Shih për shembull: [Foreign Ministry statement on the 20th anniversary of NATO aggression against Yugoslavia \[Deklaratë e Ministrisë së Jashtme me rastin e 20 vjetorit të agresionit të NATO-s kundër Jugosllavisë\] - News - The Ministry of Foreign Affairs of the Russian Federation \[Ministria e Punëve të Jashtme e Federatës Ruse\] \(mid.ru\)](https://www.mid.ru/en/foreign_policy/news/-/news_id/1987217)

<sup>3</sup> Këshilli i Sigurisë së KB, Rezoluta 827, 25 Maj 1993, [https://www.icty.org/x/file/Legal%20Library/Statute/statute\\_827\\_1993\\_en.pdf](https://www.icty.org/x/file/Legal%20Library/Statute/statute_827_1993_en.pdf)

<sup>4</sup> [Permanent Mission of the Russian Federation to the United Nations \[Misioni i Përhershëm i Federatës Ruse në KB\] \(russiaun.ru\)](https://www.mfa.gov.ru/en/foreign_relations/missions/mission_to_un/)

Prishtinës,” dhe thirri për krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, si dhe për atë që të mos “devijohet” nga parimi i paanësisë së ndërmjetësimit, duke synuar kështu shkatërrimin e themeleve të rolit të Perëndimit, duke e paraqitur si një ndërmjetës i paaftë.

Në konferencën e saj për shtyp të 10 qershorit 2021,<sup>5</sup> Zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme Ruse, Maria Zakharova, e përsëriti qëndrimin e Federatës Ruse për dialogun Kosovë–Serbi, duke theksuar që Moskë dëshiron që “Beogradi dhe Prishtina ta arrijnë një zgjidhje të zbatueshme që është reciprokisht e pranueshme dhe në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurisë së KB. Kjo zgjidhje duhet të jetë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare dhe, po ashtu, duhet të miratohet nga Këshilli i Sigurisë së KB, meqë kjo i nënkupton përpjekjet për ta ruajtur paqen dhe sigurinë ndërkombëtare,” dhe shtoi që Moskë e përkrah një zgjidhje që “do t’i përshtatet popullit të Serbisë.” Ky qëndrim tashmë i njohur, pos që e përfshin kontradiktën midis “zgjidhjes reciprokisht të pranuar” dhe “zgjidhjes që do t’i përshtatet popullit të Serbisë,” e bën të qartë synimin e Rusesë që marrëveshjen midis Kosovës dhe Serbisë, çfarëdo që të jetë ajo, ta sjellë në Këshillin e Sigurisë të KB, ku atë do ta shkatërrojë, nëse nuk i përgjigjet interesave të politikës së saj të jashtme, apo do ta negociojë tekstin e rezolutës për fitime të vetat.

Në një konferencë tjetër për shtyp, atë të 17 qershorit 2021,<sup>6</sup> Zakharova i sulmoi Shtetet e Bashkuara për dhënien e armatimit dhe të pajisjeve ushtarake që ishin blerë nga Qeveria e Kosovës, duke pohuar se Washingtoni është “duke ua gërryer haptas themelet përpjekjeve ndërkombëtare për ta siguruar paqen dhe stabilitetin në Ballkan,” dhe duke theksuar se “ideja e Washingtonit” për ta ndërtuar ushtrinë në Kosovë është një “shkelje e drejtpërdrejtë dhe e hapur e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurisë së KB,” meqë, sipas saj, ajo e parashihet “shpërbërjen e çfarëdo njësisë paraushtarake të shqiptarëve të Kosovës dhe mundëson që vetëm kontigjenti paqeruajtës ndërkombëtar të jetë i pranishëm në territorin e Kosovës.” Kjo deklaratë është një përpjekje e Moskës që bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes midis Washingtonit dhe Prishtinës ta paraqesë si të dëmshëm për paqen dhe stabilitetin në Ballkan, garantues i të cilave, për ironi, është vetë NATO-ja, dhe, para së gjithash, Shtetet e Bashkuara, si udhëheqëse të saj, dhe duke e hedhur poshtë shtetësinë e Kosovës dhe legalitetin e zhvillimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, përmes manipulimit të përmbajtjes së Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurisë së KB, përkatësisht, të pikës 9.b., të saj, që kërkon “Demilitarizimin e Ushtrisë

---

<sup>5</sup> [Konferencë për shtyp e Zëdhënësës së Ministrisë së Jashtme Maria Zakharova, Moskë, 10 qershor 2021 - News – Ministria e Punëve të Jashtme e Federatës Ruse \(mid.ru\)](#)

<sup>6</sup> [Konferencë për shtyp e Zëdhënësës së Ministrisë së Jashtme, Maria Zakharova, Moskë, 17 qershor 2021 - Asia-Europe Meeting \[Takimi Azi – Evropë\] \(ASEM\) – Ministria e Punëve të Jashtme e Federatës Ruse \(mid.ru\)](#)

Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe të grupeve të tjera të armatosura ... .”<sup>7</sup> Lidhur me këtë, duhet të përmendet se çarmatosja e kërkuar dhe shpërbërja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe e grupeve të tjera të armatosura të shqiptarëve është përfunduar në shtator të vitit 1999. Nga ana tjetër, Forca e Sigurisë së Kosovës nuk është një “grup i armatosur shqiptar,” por një forcë e armatosur multi-etnike, dhe as edhe një nen i vetëm i Rezolutës 1244 të KS KB nuk e ndalon krijimin dhe zhvillimin e saj.

Në kuadër të të gjithë kësaj, Ministri i Jashtëm Rus, Sergey Lavrov, në artikullin e tij “Ligji, të Drejtat dhe Rregullat,”<sup>8</sup> të botuar menjëherë pas Samitit Biden–Putin në Gjenevë, pos kritikave të tij të vrazhda ndaj Perëndimit, dhe posaçërisht ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ndër të tjera flet në një mënyrë tejet manipuluese për legalitetin e pavarësisë së Kosovës. Lidhur me këtë, ai pohon se “rendi [Perëndimor] i mbështetur në rregulla është mishërim i standardeve të dyfishta. E drejta për vetë-vendosje është një “rregull” absolute, sa herë që mund të përdoret për avantazh të vetin, ... ashtu siç Kosova e fitoi “pavarësinë” e saj me shkeljen e rezolutës së Këshillit të Sigurisë të KB. Mirëpo, kur vetëvendosja shkon kundër interesave gjeopolitike Perëndimore, ashtu siç ndodhi kur populli i Krimesë votoi për t’u ribashkuar me Rusinë, ky parim shtyhet mënjanë, ndërsa dënohet zgjedhja e lirë që e ka bërë populli dhe ai dënohet me sanksione.” Në një mënyrë ironike, Lavrovi është duke u përpjekur që Rusinë ta paraqesë si një vend që e respekton të drejtën ndërkombëtare dhe multilateralizmin, ndërkohë që e dëshmon pikërisht të kundërtën, duke e mohuar vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për ligjshmërinë e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës,<sup>9</sup> dhe në të njëjtën kohë kur është duke e akuzuar Perëndimin për mospranimin e aneksimit të paligjshëm të Krimesë, dhe për futjen e sanksioneve ndaj politikës agresive ruse në fqinjësinë e saj të afërt.

Për më tepër, më 8 korrik 2021, Ministria e Jashtme Ruse e botoi raportin “Gjendja e të Drejtave të Njeriut në Disa Vende,” i cili flet për të gjitha vendet evropiane, Shtetet e Bashkuara, dhe për Australinë, me përjashtim të Serbisë dhe të Bellorusisë. Raporti Kosovës ia kushton një pjesë të veçantë të gjatë, e cila, për ta argumentuar “gjendjen e të drejtave të njeriut” në vend i shfrytëzon vetëm katër burime, dhe atë pa iu referuar në mënyrën e duhur. Ndër të tjera, raporti i akuzon autoritetet e Kosovës për shtypjen e komuniteteve të veta jo-shumicë, dhe posaçërisht të serbëve

---

<sup>7</sup> Rezoluta 1244 e KS KB, 10 qershor 1999,

[https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/990610\\_SCR1244%281999%29.pdf](https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/990610_SCR1244%281999%29.pdf)

<sup>8</sup> Artikull nga Sergey Lavrov, Ministër Rus i Punëve të Jashtme, “The Law, the Rights and the Rules” [“Ligji, të drejtat, dhe rregullat”], Moskë, 28 qershor 2021 - Nota bene - Ministria e Punëve të Jashtme e Federatës Ruse (mid.ru)

<sup>9</sup> ICJ, Advisory Opinion, Accordance with international law of the unilateral declaration of independence in respect of Kosovo [GJND, Opinioni Këshillues, Pajtimi me të drejtën ndërkombëtare i shpalljes së njëanshme të pavarësisë lidhur me Kosovën], 22 korrik 2010, <https://www.icj-cij.org/public/files/case-related/141/16012.pdf>

lokalë dhe të Kishës Ortodokse Serbe, për krijimin e Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për ngritjen e mandatit të Forcës së Sigurisë së Kosovës me mbrojtjen e sovranitetit dhe të integritetit territorial, “në kundërshtim” me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurisë të KB, për mosrespektimin e marrëveshjes për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, për mosfunktionimin e sundimit të ligjit, për korrupsion dhe krim të organizuar, dhe për atë që është vendi që është burim kryesor i origjinës, kalimit dhe destinimit të operacioneve ilegale që kanë të bëjnë me trafikimin e qenieve njerëzore, të narkotikëve dhe armëve, dhe për kontrabandë.

Është interesante që në një artikull agresiv të Putinit, “Për Unitetin Historik të Rusëve dhe Ukrainasve,”<sup>10</sup> të botuar më 12 korrik, 2021 në të cilin ai nuk ngurron t’i vejë në pyetje kufijtë midis shteteve që u shfaqën nga ish Bashkimi Sovjetik, ai në mënyrë ironike i jep mësim Ukrainës për atë se si është vendi më i varfër i Evropës, “duke qenë më e varfër” ... madje edhe se “Kosova e papranuar.”

Për më tepër, në konferencën për shtyp të 29 korrikut 2021,<sup>11</sup> i ngarkuari me punë i Misionit të Përhershëm Rus në KB, Dmitry Polyanskiy, theksoi se Rusia është duke kërkuar një qasje të balancuar ndaj ndjekjes së krimeve të luftës, duke e patur parasysh se, sipas tij, serbët ishin shënjestër në shumicën e rasteve, ndërkohë që grupet e tjera entike u trajtuan në një mënyrë disi të ndryshme, pa dhënë dëshmi të prekshme, dhe e cila në thelb është një përpjekje për t’ia shkatërruar themelet kredibilitetit të drejtësisë ndërkombëtare, si dhe narrativat për krimet e luftës në ish-Jugosllavi. Është interesante që në këtë deklaratë Rusia për herë të parë shpreh dyshime për kredibilitetin e informatave për marrjen e organeve gjatë luftës në Kosovë, e cila, sipas Raportit Inhuman treatment of people and illicit trafficking in human organs in Kosovo [Trajtimi johuman i njerëzve dhe trafikimi i jashtëligjshëm me organe njerëzore në Kosovë] (7 janar, 2011),<sup>12</sup> të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, pretendohet se janë kryer nga pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në këtë drejtim, më 4 gusht 2021, Ministria e Jashtme Ruse e botoi dokumentin për qëndrimin e Rosisë në sesionin e ardhshëm (të shtatëdhjetë e gjashtë) të Asamblesë së Përgjithshme të KB,<sup>13</sup> në të

---

<sup>10</sup> Vladimir Putin, “Për Unitetin Historik të Rusëve dhe Ukrainasve”, 12 korrik, 2021,

<http://en.kremlin.ru/events/president/news/66181>

<sup>11</sup> [Permanent Mission of the Russian Federation to the United Nations \[Misioni i Përhershëm i Federatës Ruse në Kombet e Bashkuara\] \(russiaun.ru\)](https://www.un.org/press/en/2021/210729russianmission.shtml)

<sup>12</sup> Raport i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës “Trajtimi johuman i njerëzve dhe trafikimi i jashtëligjshëm me organe njerëzore në Kosovë” (7 janar 2011) <https://pace.coe.int/en/files/12608/html>

<sup>13</sup> Sesioni i 76 i Asamblesë së Përgjithshme do të hapet me 14 shtator, dhe do të mbyllet më 30 shtator, 2021, General Assembly, Opening dates of forthcoming regular sessions of the General Assembly and of the general debate, February 15<sup>th</sup>, 2021 [Asambleja e Përgjithshme, Datat e hapjes së sesioneve të ardhshme të rregullta të Asamblesë së Përgjithshme dhe të debatit të përgjithshëm, 15 shkurt, 2021], <https://undocs.org/en/A/INF/76/1>

cilin pika 23 i kushtohet “zgjidhjes së çështjes së Kosovës.”<sup>14</sup> Përmbajtja e kësaj pike tregon qartë vazhdimësinë e qendrimit rus dhe të luftës diplomatike kundër Kosovës. Para së gjithash, dhe mbi të gjithat, Moska synon që shtetësinë e Kosovës ta paraqesë si një çështje të papërfunduar, duke deklaruar se “zgjidhja” e saj duhet të bazohet në të drejtën ndërkombëtare dhe në Rezolutën 1244 të KS KB. Për më tepër, Rusia e shpërfill Opinionin Këshillues të GJND-së për ligjshmërinë e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, dhe e keqinterpreton Rezolutën 64/298 të AP KB të 9 shtatorit 2010, e cila e bën të ditur Opinionin Këshillues dhe e përcakton se qëllimi i dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja midis Kosovës dhe Serbisë “do të jetë që ta çojë përpara bashkëpunimin, të arrijë përparim në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe në përmirësimin e jetëve të njerëzve,”<sup>15</sup> dhe që kjo nuk ka të bëjë fare me shtetësinë e Kosovës.

Në një konferencë për shtyp të Zëvendës Drejtorit të Informimit të Ministrisë së Jashtme dhe të Departamentit të Shtypit, Alexander Bikantov, të 5 gushtit 2021, në pjesën “Përgjigjet në pyetjet e mediave,” Kosova u trajtua nën titullin “Planet e 10 vendeve afrikane dhe aziatike për ta tërhequr njohjen e Kosovës.” Bikantov së pari deklaroi që Rusia synon që me vendosmëri ta ndjek politikën që “zgjidhja reciprokisht e pranueshme” midis Beogradit e Prishtinës duhet të bazohet në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurisë së KB, të miratuar nga Këshilli i Sigurisë së KB, dhe që Moska “do të pajtohet vetëm me zgjidhjen që u përshtatet serbëve.” Kjo deklaratë po ashtu sjell në sipërfaqe synimin e Rusisë që, ose Serbinë ta kthejë në peng të synimeve të veta, që t’i pengojë përpjekjet e Bashkimit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës e Serbisë, ose që ta rrëzojë kërkesën e mundshme të Kosovës për anëtarësi në Kombet e Bashkuara, në rast të një marrëveshjeje që është nën njohjen formale nga Serbia. Nga ana tjetër, sa i përket moratoriumit njëvjeçar për anëtarësinë e Kosovës në organizatat ndërkombëtare, dhe ndërprerjen e fushatës së Serbisë për tërheqjen e njohjeve të pavarësisë së

---

<sup>14</sup> Pika 23, Qëndrimi i Rusisë në sesionin e shtatëdhjetë e gjashtë të Asamblesë së Përgjithshme të KB, 4 gusht 2021, “Zgjidhja e çështjes së Kosovës duhet të mbështetet në të drejtën ndërkombëtare, dhe së pari dhe mbi të gjithat, në Rezolutën 1244 të KS KB. Beogradi dhe Prishtina duhet të vijnë vetë deri te një marrëveshje, ndërkohë që detyra e bashkësisë ndërkombëtare është që t’i ndihmojë palët për të gjetur zgjidhje të pranueshme pa presion të jashtëm. BE-ja, si ndërmjetësues në dialog në pajtim me rezolutën 64/298 të AP KB të 9 shtatorit 2010, duhet të përpiqet të sigurojë që palët t’i jetësojnë vendimet për të cilat është arritur pajtimi, dhe para së gjithash, themelimin e Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë (CSMK; marrëveshja e arritur në vitin 2013 ende nuk është implementuar). E përkrahim punën e Misionit të Administratës së Përkohshme të KB (UNMIK),”

[Russia's position at the seventy-sixth session of the UN General Assembly - Conflicts - The Ministry of Foreign Affairs of the Russian Federation \[Qëndrimi i Rusisë në sesionin e shtatëdhjetë e gjashtë të Asamblesë së Përgjithshme të KB – Konfliktet – Ministria e Punëve të Jashtme të Federatës Ruse\] \(mid.ru\)](#)

<sup>15</sup> Pika 2, Rezoluta 64/298 e AP KB, 9 shtator 2010, <https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/ROL%20A%20RES64%20298.pdf>



Kosovës, që u arrit në Washington më 4 shtator 2020,<sup>16</sup> dhe i cili efektivisht do të përfundojë pas disa ditësh, Bikantov pohoi që çfarëdo revidimesh të “vendimit të gabuar për të njohur Kosovën, është zgjedhje sovrane e disa anëtarëve të bashkësisë ndërkombëtare, dhe “rezultat i një analize të drejtë të situatës, përfshirë edhe atë të sjelljes së Prishtinës.” Pos kësaj, ai e akuzoi Prishtinën për obstrukcion të procesit të dialogut që nga viti 2013, dhe posaçërisht për moszbatimin e marrëveshjes për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, dhe, nga ana tjetër, e kritikoi BE-në, si ndihmues të dialogut, për mungesë të një reagimi të qartë ndaj “obstruksioneve” të Kosovës.


---

<sup>16</sup> Pika për moratoriumin në Marrëveshjen e Washingtonit, “Kosova (Prishtina) do të pajtohet ta zbatojë një moratorium njëvjeçar në kërkimin e anëtarëve të reja në Organizatat Ndërkombëtare. Serbia (Beogradi) do të pajtohet me një moratorium njëvjeçar në fushatën e vet të çnjohjeve, dhe do të përmbahet formalisht apo joformalisht nga kërkimi nga çfarëdo shteti apo Organizate Ndërkombëtare që të mos e njohë Kosovën si shtet. Që të dyja marrëveshjet për të hequr dorë do të hyjnë në fuqi menjëherë,” <https://www.new-perspektiva.com/wp-content/uploads/2020/09/Washington-Agreement-Kosova-Serbia.pdf>

## Dezinformatat e Mediave Ruse për Kosovën

Mediat e përzgjedhura që origjinën e kanë në Rusi, dhe që janë monitoruar nga 1 qershor deri më 15 gusht, 2021, janë Russia Today, Sputnik International, Sputnik Serbia, Meduza, Russia Insider, TASS, The Moscow Times, Newsfront, Unz, The Duran dhe Pravda Report.


Monitorimi i të dhënave tregon se gjatë kësaj periudhe këto botime mediale me origjinë në Rusi i kanë publikuar 500 lajme që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kishin të bënin me Kosovën. Sputniku – botimi në serbisht i botoi 457 lajme, Sputnik International 16, Russia Today 7, Russia Insider 3, Meduza asnjë, TASS-i 10, The Moscow Times asnjë, Pravda Report asnjë, Newsfronti 1, UNZ-i 4 dhe Duran 2.



Një vështrim që e bëri KIPRED-i, të lajmeve të botuara nga këto media, tregon se nga 500 lajmet që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kishin të bënin me Kosovën, 96 (apo 19.2%) prej tyre kishin përmbajtje me dezinformata.




Numri më i madh i dezinformatave është botuar nga Sputnik Serbia (71), pasuar nga TASS (9), Russia Today (4), UNZ (4), Sputnik International (3), Russian Insider (2), The Duran (2) dhe Newsfront (1).




Me qëllim që ta kemi një pamje më të mirë të veçorive dezinformuese që e shënjestrojnë Kosovën, përqëndrimi kryesor i përmbajtjeve të lajmeve të botuara nga mediat e përmendura më sipër të Rusisë ka qenë i grumbulluar në këto synime dezinformuese:

- Rrënimi i themeleve të legalitetit të shtetësisë dhe sovranitetit të Kosovës.
- Ndryshimi i narrativave të luftës dhe të krimeve të luftës në ish-Jugosllavi.
- Rrënimi i kredibilitetit të angazhimit Perëndimor në shtet-ndërtimin në Kosovë dhe në dialogun Prishtinë–Beograd.
- Paraqitja e komunitetit serb dhe e Kishës Ortodoske Serbe në Kosovë si të shtypura dhe të kërcënuara.

Sa i përket përmbajtjes së lajmeve që kanë pasur dezinformata dhe që janë botuar nga këto media ruse, numri më i madh i tyre ka synuar ta rrënojë legalitetin e shtetësisë dhe të sovranitetit të Kosovës (32), pasuar nga paraqitja e komunitetit serb dhe Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë si të shtypura dhe të kërcënuara (24), ndryshimi i narrativave të luftës dhe të krimeve të luftës në ish-Jugosllavi (24), dhe rrënimi i kredibilitetit të angazhimit Perëndimor në shtet-ndërtimin e Kosovës, dhe në dialogun Prishtinë–Beograd (16).



Analiza e veçorive të përgjithshme të dezinformatave të botuara nga mediat me origjinë në Rusi tregojnë se ato kanë qenë kryesisht të përqendruara në rrënimin e themeleve të legalitetit të shtetësisë dhe të sovranitetit të Kosovës, në ndryshimin e narrativave të luftës dhe të krimeve të luftës në ish-Jugosllavi, dhe në rrënimin e themeleve të kredibilitetit të angazhimit Perëndimor në shtet-ndërtim dhe në dialogun Prishtinë–Beograd, me përjashtim të Sputnik Serbia që një vëmendje të veçantë në dezinformata ia jap paraqitjes së komunitetit serb dhe të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë si të shtypura dhe të kërcënuara.



## Konkluzione

Një moment shumë i rëndësishëm në luftën diplomatike ruse kundër Kosovës do të krijohet pas përfundimit të marrëveshjes për moratoriumin e Kosovës për të aplikuar për anëtarësi në organizatat ndërkombëtare, dhe të fushatës së Serbisë për çnjohjen e Kosovës, që do të përfundojnë më 3 shtator 2021, dhe kjo do të përputhet me hapjen e Sesionit të 76 të Asamblesë së Përgjithshme të KB. Ky moment mund të shfrytëzohet nga Rusia për të punuar bashkërisht me Serbinë për ta zbatuar një fushatë agresive për çnjohjen e Kosovës gjatë zhvillimit të Sesionit dhe menjëherë pas tij.

Lidhur me këtë, analizat e deklaratave, të konferencave për shtyp, artikujve dhe të dokumenteve të tjerë të establishmentit të politikës së jashtme ruse, nga 1 qershori deri më 15 gusht 2021, tregojnë qartë vazhdimësinë e synimeve të narrativave për t'ia gërrmuar themelet shtetësisë së Kosovës dhe angazhimit perëndimor në Kosovë dhe rajon, për t'i ndryshuar narrativat për krimet e luftës në ish-Jugosllavi, duke ia rrënuar kësaj themelet drejtësisë ndërkombëtare, për ta akuzuar Kosovën për shtypjen e serbëve lokalë dhe të Kishës Ortodokse Serbe, dhe për mosrespektimin e marrëveshjes për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, si dhe për ta krahasuar rastin e Kosovës me atë të Krimesë. Këta narrativë e strukturojnë luftën diplomatike të Ruisë kundër Kosovës.

Pos kësaj, analiza e veçorive të përgjithshme të dezinformatave të botuara nga mediat me origjinë në Rusi tregojnë se ato kanë qenë kryesisht të përqendruara në rrënimin e themeleve të legalitetit të shtetësisë dhe të sovranitetit të Kosovës, në ndryshimin e narrativave të luftës dhe të krimeve të luftës në ish-Jugosllavi, dhe në rrënimin e themeleve të kredibilitetit të angazhimit Perëndimor në shtet-ndërtim dhe në dialogun Prishtinë–Beograd, me përjashtim të Sputnik Serbia që një vëmendje të veçantë në dezinformata ia jap paraqitjes së komunitetit serb dhe të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë si të shtypura dhe të kërcënuara.

Në këto rrethana, Qeveria e Kosovës, në koordinim me partnerët e saj Perëndimorë, duhet të përgatitet mirë për Sesionin vijues të Asamblesë së Përgjithshme të KB, me qëllim që ta shmangë ndonjë tërheqjeje të papritur të ndonjë njohjeje. Në këtë drejtim, Qeveria e Kosovës duhet t'u drejtohet anëtarëve të KB me një dokument të përshtatshëm që i kundërvihet narrativave ruse dhe serbe kundër shtetësisë dhe sovranitetit të Kosovës, dhe të bëjë fushatë për njohjet e mëtutjeshme.

Ky moment është posaçërisht i rëndësishëm për shkak të faktit që çdo njohje apo çnjohje e mëtutjeshme e Kosovës do të ketë një ndikim serioz në procesin e dialogut me Serbinë, duke patur parasysh që kjo do të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në forcën e pozitive së çdonjërit prej tyre.